



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 04.04.2023

Nr: 45

Ora: 12:30

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 38, DATË 27.03.2023 TË DEPOZITUAR NGA QENDRA "QËNDRESA QYTETARE"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 04.04.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Qendra "Qëndresa Qytetare", përfaqësuar nga z. Dhimitër Zguro

**PALË E INTERESUAR :** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësuar nga z. Olsi Akshia

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 199, datë 24.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"



**BAZË LIGJORE:**

Nenet 21, pika 1, shkronja "b", 123/1, 124, 133-136 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

**Rrethanat e çështjes:**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 39 (tridhjetë e nëntë) veprimtarive publike, nga 24 (njëzet e katër) institucione publike, për të cilat pretendohet se bien në kundërshtim me parashikimet e neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nisur hetimin administrativ ndaj një sërë institucionesh, midis të cilëve edhe për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përfundim të të cilit ka konkluduar me anë të vendimit nr. 199, datë 24.03.2023 se në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj zj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe zj. Joana Duro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Leon Kaza, Drejtor i Spitalit Rajonal Lezhë dhe z. Pjerin Ndreu kryetar i bashkisë Lezhë, vlerësoi se nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

2. Kundër këtij vendimi, qendra "Qëndresa Qytetare" ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr. 38, datë 27.03.2023, duke kërkuar ndryshimin e vendimit konkretisht për pikën 1, shkronja "p" të dispozitivit, si dhe dënim me gjobë për zj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si organizatore e aktivitetit të zhvilluar në Spitalin Rajonal të Lezhës.

3. Përfaqësuesi i subjektit ankues z. Dhimitër Zguro parashitroi se vendimi nr. 199, datë 27.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet ndryshuar, duke kërkuar vendosjen e masës administrative për Ministrin e Shëndetësisë. Në datën 7 shkurt 2023, zj. Ogerta Manastirliu së bashku me Ministrin e Drejtësisë z. Ulsi Manja dhe Kryetarin e Bashkisë Lezhë z. Pjerin Ndreu

kanë marrë pjesë në një vizitë në Spitalin Rajonal të Lezhës. Me këtë fakt janë njohur me anë të një postimi video, në profilin zyrtar të Facebook të Ministres së Shëndetësisë duke përdorur dhe hashtag me slogane të partisë politike që përfaqësojnë. Më datë 8 shkurt, në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë është publikuar lajmi mbi këtë vizitë në Spitalin Rajonal të Lezhës, ku është shprehur mbi punën që është kryer në këtë spital si dhe investimet e ardhshme që do të kryhen, duke i reklamuar dhe i promovuar në këtë spital. Gjatë kësaj vizite ka mbajtur fjalën dhe z. Manja, duke mbështetur në mënyre indirekte kandidatin për kryetar bashkie z. Pjerin Ndreu. Ankuesi pretendon se janë përdorur burime publike, siç është ambienti i spitalit në orar pune, me pjesëmarrjen e stafit mjekësor dhe personave që kanë qenë prezent për të kryer vizitat e tyre rutinë shëndetësore.

4. KAS-i caktoi me short anëtarin z. Ledio Braho si relator dhe vendosi shqyrtimin e seancës në datën 04.04.2023, ora 12:30. Në seancën e shqyrtimit administrativ ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, pala ankimuese, përfaqësuar nga z. Dhimitër Zguro dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Olsi Akshia.

5. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 38, datë 27.03.2023;
- Vendimin nr. 199, datë 24.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

#### **KAS-i konstatoi:**

1. Ankuesi, Qendra "Qëndresa Qytetare" ka paraqitur ankim ndaj vendimit të Komisionerit nr. 199, datë 24.03.2023 vetëm sa i takon shkronjës "p" të pikës 1 të dispozitivit, e cila bën fjalë për pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Ogerta Manastirliu, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ankuesi çmon se "organizimi nga ana e Ministrit të Shëndetësisë të një vizite në Spitalin Rajonal të Lezhës, duke përmendur dhe promovuar investimet e kryera deri më tani dhe investimet që planifikohen të kryhen në vijim, si dhe pjesëmarrja e drejtuesit politik

të PSSH-së në këtë aktivitet, vërtetojnë katërcipërisht se nga ana e Ministrit të Shëndetësisë janë përdorur burime publike në mbështetje të Partisë Socialiste dhe për rrjedhojë, Ministria e Shëndetësisë duhet të gjendet përgjegjëse për shkeljen e kryer”.

2. Lidhur me këtë ankim ka rëndësi të ndahen disa konsiderata faktike dhe disa konsiderata ligjore, të cilat nuk kanë vlerë vetëm për zgjidhjen në përputhje me ligjin të këtij rasti, por kanë vlerë sidomos për vendosjen e një standardi uniform gjykimi.

#### **Konsiderata faktike:**

1. Veprimtaria e denoncuar nga “Qëndresa Qytetare” është një veprimtari me karakter të qartë politik/elektoral. Veprimtaria ka pasur qëllim promovues jo vetëm të një investimi të kryer, por edhe të politikave qeveritare në fushën e shëndetësisë, specifikisht për shëndetësinë në Qarkun Lezhë. Veprimtaria promovuese e ministrit nuk është e huaj për funksionin e tij, nuk është, në vetvete, e kundërligjshme. Vetëm koha kur kryhet ajo mund të shkaktojë përplasje me ligjin.
2. Veprimtaria e denoncuar është zhvilluar në kuadër të veprimtarive politiko-elektorale të Partisë Socialiste, gjegjësisht në dobi të saj. Ndryshe nuk ka shpjegim, as justifikim, pjesëmarrja në veprimtari e drejtuesit politik të Qarkut Lezhë. Pjesëmarrja e Kryetarit të Bashkisë Lezhë, gjithashtu, mund të vlerësohet në këtë kontekst, sa kohë që kryetari i bashkisë Lezhë ka qenë në momentin e zhvillimit të veprimtarisë (data 07.02.2023) kandidat i deklaruar i subjektit “Partia Socialiste” për zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Veprimtaritë në dobi të subjektit politik nga ana e këtyre zyrtarëve shtetërorë nuk janë, në vetvete, të kundërligjshme. Vetëm koha kur kryhen ato mund të shkaktojë përplasje me ligjin.
3. Veprimtaria e denoncuar është veprimtari publike, sepse është zhvilluar në një mjedis publik, siç është Spitali Rajonal Lezhë, në prani dhe në komunikim me publikun (patientët) e ndodhur aty. Ajo është raportuar rregullisht nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në ndërfaqen e KQZ-së për raportimin e veprimtarive publike. Pretendimi i shprehur nga ana e përfaqësuesit të Ministrisë gjatë hetimit administrativ, se veprimtaria nuk ka qenë e hapur për publikun nuk ka bazë faktike.
4. Veprimtaria e denoncuar është zhvilluar në mjediset e Spitalit Rajonal Lezhë, i cili është “burim i një enti publik”, aset i paluajtshëm në kuptimin e pikës 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Ky

burim publik “nuk mund të përdoret ose të vihet në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve **NË ZGJEDHJE**”, sepse pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor e ndalon këtë gjë.

5. Pretendimi i ankuesit “Qëndresa Qytetare”, se veprimtaria e denoncuar është “veprimtari e ndaluar për t’u promovuar” është një pretendim që, sipas pohimit të vet, ankuesi nuk e provon dot. Sipas vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 “veprimtari të ndaluar për tu promovuar janë veprimtaritë publike..., për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë ... mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, **TË SHËNDETIT**, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik” (nënpika 1.1 e pikës 1 të nenit 3). Deklarimi i përfaqësuesit të Ministrisë se fondet për “investimin në shërbimin e radiologjisë në spitalin rajonal të Lezhës” ishin vënë në dispozicion përpara datës 13 janar 2023, është konsideruar fakt i mirëqenë nga Komisioneri dhe për vërtetimin e tij administrata e KQZ-së nuk ka kryer veprime gjatë hetimit administrativ.
6. Pretendimi i ankuesit “Qëndresa Qytetare”, se veprimtaria e denoncuar është “veprimtari e ndaluar”, në kuptim të shkronjës “c” të nënpikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020, rezulton se nuk është marrë në shqyrtim nga Komisioneri. Sipas vendimit të sipërcituar “Veprimtari të ndaluar janë edhe ato veprimtari që përfshijnë ... vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”. Përdorimi i mjediseve të spitalit rajonal Lezhë për kryerjen e veprimtarisë është një fakt i provuar dhe i pranuar nga palët.
7. Për shkak se Komisioneri nuk e ka marrë në konsideratë pretendimin e ankuesit për zhvillimin e një veprimtarie të ndaluar, në kuptim të shkronjës “c” të nënpikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3 të

vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020, ai nuk ka zhvilluar hetime për të vlerësuar përgjegjësinë administrative të subjektit 'Partia Socialiste', në dobi të të cilit është zhvilluar veprimtaria, sikurse nuk ka zhvilluar hetime ndaj drejtorit të spitalit rajonal Lezhë, i cili ka përgjegjësinë e administrimit të asetit që është vënë në dispozicion për ushtrimin e veprimtarisë.

8. Ankuesi pretendoi se prania e mjekëve të spitalit rajonal Lezhë në veprimtari e bën gjithashtu veprimtarinë që të cilësohet "veprimtari e ndaluar", në kuptim të shkronjës "ç" të nënpikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, sipas të cilit veprimtari e ndaluar është edhe veprimtaria që përfshin "*përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore*". Ky pretendim nisët nga prezumimi se pjesëmarrja e mjekëve në veprimtari është bërë me detyrim, kur në fakt kjo është gjëja që duhet të provohet për t'a klasifikuar veprimtarinë si "veprimtari të ndaluar". Në mungesë të provës, pretendimi nuk mund të konsiderohet i mbështetur në fakte.

#### Konsiderata ligjore:

1. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se "*...nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve **NË ZGJEDHJE** burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia*". Kjo dispozitë është përsëritur në mënyrë të ngjashme edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 në përkufizimin e "*veprimtarive të ndaluara*" kur ndalon "*vënien në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për **QËLLIME ZGJEDHORE***".
2. Kodi ka përcaktuar periudhën e fushatës zgjedhore, si një periudhë që zgjat nga 30 ditë para datës së zgjedhjeve, deri 24 orë para datës së zgjedhjeve (neni 77), ka përcaktuar periudhën kur nuk lejohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve të caktuara ligjore ose nënligjore, e cila është katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve (pika 4 e nenit 91), por nuk ka përcaktuar periudhën kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91, kur fillojnë "**ZGJEDHJET**" dhe as kur mbarojnë ato. Nga ana tjetër nuk ka asnjë akt me karakter

normativ nga ana e KQZ-së që të përcaktojë momentin kur fillon të veprojë ndalimi i përdorimit të burimeve të organeve apo enteve publike që kërkon ky nen. Vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 nuk e ka saktësuar këtë përkufizim. Në nënpikën 1.3, të pikës 1 të nenit 3 të tij, teksa jep përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara”, vendimi vendos afatin për të cilin vepron ndalimi për secilën nga kategoritë e veprimtarive të ndaluara, me përjashtim të veprimtarive të përkufizuara nga shkronja “c” dhe nga shkronja “dh” e tij, për të cilat nuk ka afat.

3. Në kushtet e mungesës së një përcaktimi detyrues që do t’a vendoste fillimin e veprimit të afatit të ndalimit në një datë më të hershme, subjektet zgjedhore dhe institucionet janë të lira ta çojnë afatin në limitin e tij ligjor, që është data e fillimit të fushatës zgjedhore, d.m.th. 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kjo nuk do të formonte shkelje të ligjit, sepse **“PERIUDHA E FUSHATËS ZGJEDHORE”** sikurse është përcaktuar nga Kodi Zgjedhor e mbulon konceptin **“ZGJEDHJE”** të pikës 1 të nenit 91.
4. KAS-i mund të marrë masa administrative ndaj subjekteve ose përfaqësuesve të institucioneve vetëm nëse konstaton shkeljen e dispozitave të caktuara detyruese ligjore, por nuk mund të sanksionojë administrativisht për veprime, të cilat nuk është ligjërish e qartë nëse janë kryer brenda apo jashtë periudhës së ndalimit. Kuadri ligjor i paqartë nuk mund të zbatohet në dëm të subjekteve. Ndëshkim pa shkelje dhe pa faj nuk mund të ketë.
5. Mungesa e përkufizimit të afatit të ndalimit sipas pikës 1 të nenit 91 çon në krijimin e një praktike institucionale inkoherente, në rastin më të keq, me standart të dyfishtë. Prandaj, plotësimi i këtij boshllëku rregullator vlen të trajtohet me prioritet.
6. Nëse kuadri rregullator i zgjedhjeve do ishte kompletuar edhe me përkufizimin e afatit kur fillon të veprojë ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91, duke e lidhur atë me periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, atëhere veprimtaria e denoncuar nga “Qëndresa Qytetare” do të ishte “veprimtari e ndaluar”, në kuptimin e shkronjës “c” të nënpikës 1.3 të pikës 1 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr.9, datë 24.12.2020.
7. Pika 2 e nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 përcakton se zyrtarët e lartë të Ekzekutivit dhe titullarët e një numri institucionesh *“e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo formë, në veprimtari publike të ndaluara ... gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve”*. Kjo

dispozitë ndaluese është vendosur rishtazi me vendimin e Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, por nuk ka referencë korresponduese në ndonjërin nga dispozitat sanksionuese të Kodit Zgjedhor. Kjo mungesë mund të sjellë zbatimin inkohorent të sanksioneve administrative, në rastin më të keq, me standard të dyfishtë.

8. Pika 1 e nenit 172 të Kodit Zgjedhor përcakton se *“subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”*. Zhvillimi i *“veprimtarive të ndaluara”* dhe, eventualisht, pjesëmarrja apo kontributi në çfarëdolloj forme i zyrtarëve të lartë të Ekzekutivit dhe titullarëve të institucioneve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, në veprimtari publike të ndaluara, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve bëjnë pjesë tek *“ndalimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji”*. Kjo do të thotë se hetimi administrativ për zhvillimin e veprimtarive të ndaluara apo për rolin e zyrtarëve të lartë të Ekzekutivit a të titullarëve të institucioneve në to duhet të shoqërohet në çdo rast edhe me hetimin për rolin e subjektit zgjedhor përfitues nga veprimtaria. Në përfundim të hetimit administrativ si Komisioneri, ashtu dhe KAS-i duhet të mbajnë qëndrim dhe vlerësim të shprehur për këtë rol.
9. Pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor përcakton sanksionin për shkeljet e kryera *“nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga **PERSONA TË NGARKUAR ME DETYRA, sipas këtij Kodi**”*. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucioneve të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a perfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit), Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile (për nxjerrjen e urdhërave për listat dhe zonant e qendrave të votimit) etj. Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor. Titullari i institucionit apo entit që ka në administrim aset publik nuk bën pjesë në listën e *“personave të ngarkuar me detyra, sipas Kodi”*. Sanksioni për të nuk mund të vendoset sipas pikës 1 të



nenit 171 të Kodit Zgjedhor. Dispozita e aplikueshme për sanksionim mbetet ajo e pikës 2 të nenit 171.

Bazuar në këtë analizë të fakteve dhe të kuadrit ligjor, KAS-i nuk e gjen të mbështetur kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në mungesë të përcaktimit ligjor të afatit kur vepron ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, është e pamundur për KAS-in ta cilësojë veprimtarinë e denoncuar “veprimtari të ndaluar”, përveçse pasi të ketë filluar “periudha e fushatës zgjedhore”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 143, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i me shumicë votash

#### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 38, datë 27.03.2023 të paraqitur nga Qendra “Qëndresa Qytetare”.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 199, datë 24.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>	<b>(Kundër)</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>	
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>	<b>(Kundër)</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>	
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>	

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 38, datë 27.03.2023 të Qendrës “Qëndresa Qytetare” me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 199, datë 24.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023””, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtuara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte kërkesën ankimore për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ndaj personave të tjerë në zbatim të nenit 143 pika 2 të K.Zgjedhor, pavarësisht kërimit të ankimuesit.
2. Në datën 7 shkurt 2023, Ministri i Shëndetësisë Znj. Ogerta Manastirliu, së bashku me Ministrin e Drejtësisë, njëherazi dhe Drejtues Politik i Partisë Socialiste të Shqipërisë Z. Ulsi Manja, dhe me Kryetarin e Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu kanë marrë pjesë në një vizitë me Spitalin Rajonal të Lezhës. Në orën 12:41, Znj. Manastirliu ka postuar në profilin e saj zyrtar në rrjetin social *Facebook* një video, me kohëzgjatje 9 minuta e 46 sekonda.
3. Në datën 8 shkurt 2023, në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë është publikuar lajmi me titull “Manastirliu: Gati investimi madhor për transformimin e spitalit rajonal të Lezhës”.<sup>1</sup> Përmbajtja e këtij lajmi është si vijon: “Prioritet fuqizimi i shërbimit spitalor në të gjithë qarkun e Lezhës. Kemi përfunduar Spitalin e Laçit, kemi filluar punën për rehabilitim në Spitalin Bashkiak të Mirditës dhe tashmë jemi gati për investimin në spitalin e Lezhës”.<sup>7</sup> Shkurt, Lezhë- Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, **bashkë me drejtuesin politik të qarkut Lezhë, Ministrin e Drejtësisë, Ulsi Manja dhe Kryetarin e Bashkisë Pjerin Ndreu, kanë parë nga afër investimet në Spitalin Rajonal të Lezhës, duke bërë me dije investimin madhor që fillon këtë vit për rikonstruksionin e godinës qendrore të këtij spitali. ‘Jemi këtu për të dhënë një lajm të mirë për qytetarët lezhjanë, fillimin e një investimi të rëndësishëm për rehabilitimin e godinës qendrore të Spitalit Rajonal të Lezhës, një investim i cili do të përmirësojë radikalisht shërbimet e urgjencës, patologjisë, pediatriisë dhe një seri**

<sup>1</sup> <https://shendetesia.gov.al/manastirliu-gati-investimi-madhor-per-transformimin-e-spitalit-rajonal-te-lezhes/>

shërbimesh që janë brenda korpusit qendror të këtij spitali’,- beri me dije Manastirliu. Ndërkohë Spitali Rajonal i Lezhës është pajisur me aparaturën e re DEXA, duke shtuar një shërbim të ri për qytetarët. ‘Pajisja më e re për matjen e densimetrisë konckore, vërtetë ka përmirësuar shërbimet dhe ka mbyllur një cikël të shërbimeve sa i përket imazherisë në këtë spital’, tha Manastirliu. Ministri Drejtësisë dhe drejtuesi politik i PS në Lezhë, Ulsi Manja ka vlerësuar punën e stafëve mjekësore të këtij spitali, teksa vuri theksin tek investimet bashkëkohore në këtë spital. ‘Spitali i Lezhës do të ofrojë të gjitha shërbimet cilësore. Posaçërisht këtu në Lezhë është meritë e mjekëve dhe infermierëve që shërbejnë në këtë strukturë dhe që në vijim do të kenë në dispozicion një sistem spitalor modern dhe pajisjet e teknologjisë së fundit’,- tha Manja. Pas ndërtimit të Maternitetit të ri të Lezhës, investimi në godinën qendrore të Spitalit Rajonal Lezhë përmbyll ciklin e investimit në këtë spital. Investimi do të përfshijë godinën qendrore të spitalit, sipërfaqje ndertimi rreth 4.000 m2, ku përfshihen të gjithë shërbimet me shtretër, reanimacioni, urgjencat pëdiatrike dhe ato për të rritur, terapia intensive, pediatria, kirurgjia, me një kapacitet 117 shtretër. Me ndërtimin e Spitalit të Kurbinit, fillimit të punimeve për Spitalin e Mirditës, investimi i ri në Spitalin e Lezhës përmbyll ciklin e investimeve të shërbimit spitalor në këtë qark.”

4. Siç pranohet edhe nga shumica e anëtarëve të KAS, veprimtaria e denoncuar nga “Qëndresa Qytetare” është një veprimtari me karakter të qartë politik/elektoral. Veprimtaria ka pasur qëllim promovues jo vetëm të një investimi të kryer, por edhe të politikave qeveritare në fushën e shëndetësisë, specifikisht për shëndetësinë në Qarkun Lezhë. Ajo është zhvilluar në kuadër të veprimtarive politiko-elektorale të Partisë Socialiste, gjegjësisht në dobi të saj. Ndryshe nuk ka shpjegim, as justifikim, pjesëmarrja në veprimtari e drejtuesit politik të Qarkut Lezhë. Po ashtu i njëjti fakt rezulton edhe nga përmbajtja e fjalimeve në aktivitet apo dhe nga shpërndarja e “çekut të bebes” ndaj dy nënave nga vetë ministrja dhe nga drejtuesi i qarkut, veprim ky krejtësisht jo në kompetencë të tyre, por thellësisht propagandues.
5. Komisioni Rregullator pranë KQZ, në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga nenet 90 dhe 92 të K.Zgjedhor, ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës

shtetërore para zgjedhjeve”. Në nenin 1 të këtij vendimi që përcakton qëllimin dhe objektin e tij, Komisioni Rregullator, ka përcaktuar se ky akt normativ është nxjerrë “... *me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake*”. Në nenin 7 shkronjat “dh” dhe “e” të këtij vendimi ku parashikohen detyrat e sekretarëve të përgjithshëm të institucioneve publike, të pavarura e të varësisë, ndër të tjera parashikohet se

*“1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë: ...*

*dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese, diktuese dhe urdhëruese apo të propagandës politike, në funksion të fushatës zgjedhore, në institucionet publike përkatëse;*

*e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e: ...*

*v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore”.*

Për ne anëtarët në pakicë, është e qartë që shfrytëzimi i aktivitetit të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përcjelljen e mesazheve elektorale propagandistike, çënon sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike dhe krijon kushte të pabarabarta (disfavorizuese) për kandidatët e tjerë apo për partitë e tjera politike që marrin pjesë në zgjedhje. Nëse një aktivitet i tillë nuk do të konsiderohej në kundërshtim me qëllimin dhe objektin e vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, atëherë duhet të pranojmë se kemi të bëjmë me një akt normativ të pazbatueshëm. Po në të njëjtin përfundim do të dilej edhe në lidhje me nenin 91 të K.Zgjedhor nëse do të pranohet që aktivitete si ato të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk çënojnë sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike. Shumica e anëtarëve të KAS e pranon faktin e përdorimit të burimeve publike në çështjen objekt shqyrtimi, por argumenton se është në pamundësi ligjore për ta konsideruar aktivitetin objekt shqyrtimi si në shkëlqje të nenit 91 të K.Zgjedhor përderisa sipas tyre si

ligjvënësi ashtu dhe Komisioni Rregullator nuk kanë përcaktuar një afat (30 ditor që lidhet me fushatën zgjedhore apo 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve) se kur fillon ndalimi i përdorimit të burimeve publike në favor të kandidatëve, partive politike ose koalicioneve në zgjedhje. Shumica e anëtarëve të KAS e trajton institutin e ndalimit të përdorimit të burimeve publike si në kushtet e “ometimit ligjor”. Ometimi ligjor është koncept tashmë i afirmuar në doktrinën juridike, praktikën gjyqësore dhe, në veçanti, atë kushtetuese. Ometimi është identifikuar, si në rastet kur norma juridike nuk ka rregulluar një marrëdhënie të caktuar, që në të vërtetë duhej të rregullohej (*ometimi absolut*), ashtu edhe kur norma nuk ka arritur të përmbushë në mënyrën e plotë dhe të duhur këtë detyrim (*ometimi relativ*).

6. Për ne anëtarët në pakicë, neni 91 pika 1 e K.Zgjedhor, në lidhje me mospërdorimin e burimeve publike nuk është në kushtet e konceptit të “ometimit relativ” për shkak të afatit, pasi kjo dispozitë duhet interpretuar së bashku me pikat e tjera të nenit 91 si dhe me nenin 92 të K.Zgjedhor. Më konkretisht, neni 91 pika 1 e K.Zgjedhor përcakton parimin e mospërdorimit të burimeve publike në zgjedhje (pa përcaktuar termin fushatë zgjedhore që detyrimisht të referon te afati 30 ditë nga dita e zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve), më tej pika 2 e nenit 91, në fjalinë e parë jep kuptimin e “burimit” duke përkufizuar llojet e burimeve në asete të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe në burime njerëzore, ndërkohë në fjalinë e dytë parashikon mospërdorimin e burimeve njerëzore (duke e përcaktuar në mënyrë eksplicite vetëm për burimet njerëzore) në fushatë zgjedhore, në këtë mënyrë vendoset dhe afati i ndalimit të burimeve njerëzore. Në pikën 3 të po të njëjtit nen, trajtohet sërish koncepti i burimeve njerëzore, por tashmë në kuptim të marrjes në punë, pushimit nga puna etj. dhe afati edhe në këtë rast lidhet me periudhën e fushatës zgjedhore. Më tej, në pikën 4 të po të njëjtit nen trajtohet një veprimtari tjetër që ka të bëjë me iniciativat ligjore apo nënligjore dhe këtu afatin e ndalimit ligjvënësi e përcakton në harkun kohor 4 muaj para ditës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë. Neni 92 i K.Zgjedhor, në pikën 1 të tij parashikon se “1. *Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj*

para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”. Më tej, në pikat 2 deri 6 të këtij neni, detajohet mënyra e raportimit, rastet kur ndalohen aktivitetet nga KQZ etj.

7. Nga arsyetimi më sipër, del qartë që për aq kohë sa raportimi i aktiviteteve publike duhet të kryhet gjatë gjithë periudhës 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, atëherë edhe ndalimi i përdorimit të burimeve publike vlen për të njëjtën periudhë. Nëse arsyetojmë *a contrario*, që nëse ndalimi i përdorimit të burimeve publike do të vlente vetëm periudhën zgjedhore, atëherë përse duhet të raportoheshin aktivitetet edhe për periudhën e hershme 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve?! Një interpretim i tillë e bën dispozitën alogjike dhe e shndërron në fiktive. Ndaj, për ne anëtarët në pakicë të KAS, neni 91 pika 1 nuk është në kushtet e konceptit të “*ometimit relativ*” sa i përket afatit të zbatimit të dispozitës, por është një dispozitë me karakter detyrues për periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.
8. Duke qenë se aktiviteti i sipërcituar, është një aktivitet publik i cili përdor burime publike për qëllime zgjedhore, si ambientet e spitalit rajonal të Lezhës së bashku me investimin në aparatura të kryer në të, faqen zyrtare te internetit të ministrisë, në zbatim të nenit 3 pika 1.3 shkronja “c” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, jemi në kushtet e një veprimtarie të ndaluar. Për këtë arsye si Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ashtu edhe drejtori i spitalit rajonal Lezhë, ngarkohen me përgjegjësi në zbatim të nenit 7 pika 1 shkronja “a” dhe shkronja “e” nën-pika “v” të vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, që më konkretisht parashikon se:

***“1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë:***

***a) organizojnë menjëherë punën dhe marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale, mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e Institucioneve shtetërore/publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës shtetërore, në nivel qendror e vendor;***

...

*e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e:*

...

*v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;”.*

Për këtë arsye, si Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ashtu edhe drejtori i spitalit rajonal Lezhe, duhet të dënohen administrativisht me gjobë në zbatim të nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor.

9. Injëjti vendim i Komisionit Rregullator ngarkon me përgjegjësi edhe Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, më konkretisht neni 3 pika 2 e tij parashikon se “2. Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, **ministri** dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrisë, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, cdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zoteron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, **gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”** dhe për aq kohë sa ministri ka pasur rol aktiv në këtë aktivitet të ndaluar, ngarkohet me përgjegjësi në zbatim të nenit 171 pika 2 e K.Zgjedhor si e vetmja dispozitë e zbatueshme në këtë rast.
10. Për ne anëtarët në pakicë, në rastin objekt shqyrtimi duhet të ishte sanksionuar administrativisht edhe Partia Socialiste e Shqipërisë në zbatim të nenit 172 pika 1 e K.Zgjedhor, për aq kohë sa nga propaganda elektorale e kryer në këtë aktivitet, është favorizuar pikërisht Partia Socialiste e Shqipërisë.
11. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimesi Qendra “Qëndresa Qytetare” është e bazuar në ligj dhe ajo duhej të ishte pranuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që duhet të ishte shfuqizuar

pjesërisht vendimi nr. 199, datë 24.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023” sa i përket aktivitetit objekt shqyrtimi administrativ në KAS dhe duhet të vendosej sanksion administrativ me gjobë ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndaj Drejtorit të spitalit rajonal Lezhë, ndaj Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë.

**Anëtarë: Elvis Çefa, Ledio Braho**